



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2023:000347

Datë: 15.12.2023

Numri i dokumentit: 05069912

C.nr.11/2023

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.G. nga Juniku, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.H avokat në Deçan, kundër të paditurës Komuna e Junikut – DKA, me seli në Junik, lidhur me çështjen juridike kompensim i shpenzimeve për shujta/ushqim në punë, me vlerë të kontestit prej 146,00 €, jashtë seancës me datë 15.12.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- Për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes –

APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit S.G. ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Junikut – DKA, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim gjatë punës (shujtave ditore), për 73 ditë pune për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datë 28.12.2020, paditësit t’ia paguajë shumën në lartësi prej 146,00 €, me kamatë ligjore prej 8 %, e cila do të llogaritet nga data 30.12.2022 (data e paraqitjes së padisë), e deri në ditën e pagesës definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 124,00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij, me padinë e datës 30.12.2022, ndër të tjera ka theksuar se paditësi është Profesor i Matematikës, pranë Gjimnazit “Kuvendi i Junikut”, në Junik, ku ka të themeluar marrëdhënie pune dhe duke u bazuar në nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit ku të punësuarve iu takon kompensim adekuat për ushqim gjatë punës dhe meqë punëdhënësi nuk e ka rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, ka kërkuar që e paditura të detyrohet, që paditësit t’ia paguaj shpërblimin për shpenzimet e ushqimit në punë në shumën prej 146,00 euro, për 73 ditë në punë, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me 28.12.2020, me kamatë ligjore prej 8 %, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në ditën e pagesës definitive, si dhe shpenzimet procedurale, të

gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, C.nr.11/23 të datës 10.10.2023, me të cilin e ka detyruar të paditurën, që të përgjigjet në padi, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 18.10.2023, duke e njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënien e përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të i kenë nëse nuk paraqesin përgjigje në padi, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

E paditura pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk kanë paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mos bindjes, ka gjetur se në rastin konkret, plotësohen të gjitha kushtet ligjore, për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë, nga neni 150 par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK, e cila dispozitë në mënyrë shprehimore parasheh se: *“Nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështet kërkesëpadia, nuk janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar vet paditësi, apo me faktet e ditura botërisht”*.

Gjykata nga provat të cilat i janë bashkëngjitur padisë dhe atë: kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe këtu të paditurës, me datë 01.09.2016; vërtetimi i datës 19.12.2022 për ditët e prezencës në punë për periudhën nga data 14.09.2020 e deri më datë 28.12.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi për këtë periudhë ka qenë i punësuar tek e paditura, po ashtu ka vërtetuar saktë numrin e ditëve të prezencës në punë.

Andaj, gjykata vlerëson se nga provat e lartcekura del baza dhe lartësia e kërkesëpadisë, ngase sipas nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 18.04.2017 të punësuarve u sigurohet kompensim në ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë dhe vlera e kompensimit të ushqimit në punë për një ditë punë është dy euro, andaj në kuptim të nenit 150 i LPK-së, e në lidhje me dispozitat nga neni 245 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ku përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paraqitur nga ana e paditësit është e bazuar dhe në këtë rast e njëjta u aprovua në tërësi si e themeltë, duke obliguar të paditurën në pagimin e detyrimit sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8 %, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK, me ç'rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124,00 €. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00 €, (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104,00 €, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës nr. Tarifor 6 dhe 17).

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.11/23, me datë 15.12.2023

Gjyqtari

Bajram Cacaj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës, e nëpërmjet të kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.